



# Luftëtarët e Huaj dhe Diaspora e Kosovës:

Rasti i Gjermanisë

Skënder Perteshi

Dokument i  
Politikave

## Abstrakt

Konfliktet në Siri dhe Irak dhe ngritja e Shtetit Islamik (IS) kanë tërhequr mijëra luftëtarë të huaj nga vendet evropiane për t'u bashkuar me konfliktin në Lindjen e Mesme. Një numër i madh i luftëtarëve të huaj i përkasin gjeneratës së dytë dhe të tretë të diasporës nga Lindja e Mesme, Afrika e Veriut apo Ballkani Perëndimor. Ky hulumtim synon të ofrojë disa të dhëna bazike rreth procesit të radikalizmit të diasporës, duke analizuar pse disa individ kosovarë nga diaspora në Gjermani i janë bashkuar organizatave të ekstremizmit të dhunshëm si IS dhe Hayat Tahrir al Sham. Në veçanti, hulumtimi identifikon disa nga pasojat ndryshimit të dinamikave sociale dhe identitetit, për shkak të ndryshimeve të lidhjes midis diasporës dhe vendit të origjinës me kalimin e kohës. Hulumtimi përfundon duke ofruar disa rekomandime të politikave, si për autoritetet politike gjermane ashtu edhe për ato kosovare, mbi forcimin e reziliencës së diasporës kosovare që jeton në Gjermani kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.


## Lidhur me këtë raport

Ky raport është shkruar si pjesë e një projekti për ndërtimin e kapaciteteve të QKSS-së mbështetur nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur (OSIFE), që synon rritjen e bashkëpunimit midis think tankeve nga Kosova dhe vendeve anëtare të BE-së. Ky punim është rezultat i bashkëpunimit midis Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Fondacionit Berghof në Gjermani.

## Rreth autorit

**Skënder Perteshi** është analist dhe studiues i anti-terrorizmit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Skënderi është autor i raporteve të shumta hulumtuese që lidhen me temat e sigurisë, siç janë lufta ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, ndërtimi i komuniteteve të qëndrueshme në Kosovë, diaspora dhe ekstremizmi i dhunshëm, ekstremizmi online dhe ofline, integriteti në sektorin e sigurisë. Skënderi ka punuar si bashkëpunëtor dhe konsulent për çështje të sigurisë në shumë organizata ndërkombëtare dhe vendore, përfshirë Fondacionin Finn Church Aid – Helsinki, Royal United Services Institute (RUSI), Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM), OSBE në Kosovë, kompania këshilluese MOONSHOT në Londër, Resolve Network USA, etj.

Ky raport mbështetet nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur (programi OSIFE).



© 2020 Operacionet e Fondacionit Berghof GmbH. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Për ta cituar këtë punim: Skënder Perteshi 2020. Luftëtarët e Huaj dhe Diaspora e Kosovës: Rasti i Gjermanisë. Dokument i Sfondit të Politikave Berlin dhe Prishtinë: Fondacioni Berghof & Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

E disponueshme në internet në korrik 2020

## Deklaratë

Pikëpamjet, mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë raport i përkasin vetëm autorit dhe nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet, mendimet dhe qëndrimet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, Fondacionit Berghof, Fondacionit për Shoqëritë Hapur ose OSIFE.

## Fondacioni Berghof

[www.berghof-foundation.org](http://www.berghof-foundation.org)  
[order@berghof-foundation.org](mailto:order@berghof-foundation.org)  
Twitter: @BerghofFnd  
Facebook: BerghofFoundation

# Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje.....	4
2. Marrëdhënia e diasporës kosovare në Gjermani me Kosovën .....	6
3. Diaspora kosovare dhe ekstremizmi i dhunshëm në Gjermani.....	8
4. Krahasimi me luftëtarë të huaj gjermanë nga diaspora LMAV .....	11
5. Përfundime dhe rekomandime .....	12
6. Referenca .....	13

## Lista e shkurtesave

LH -Luftëtar i huaj

IS -Shteti Islamik

QKSS- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BKS- Barometri i Sigurisë në Kosovë

LMAV- Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut

OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara

ShBA -Shtetet e Bashkuara të Amerikës

# 1. Hyrje

Kosova ka numrin më të mëdha të migracionit në botë (Banka Botërore 2011) si dhe diasporën më të madhe në Evropë. Më shumë se gjysma e shtetasve të Kosovës kanë të paktën një apo më shumë anëtar të familjes që jeton jashtë Kosovës. Pjesa më e madhe e diasporës kosovare gjendet në Gjermani. Në historinë fundit të Kosovës, diaspora ka luajtur një rol kyç në Kosovë. Politikisht, diaspora ka luajtur rol vendimtar në përpjekjen disa-dekadëshe për t'i dhënë fund okupimit të Kosovës nga Serbia më 1999. Ekonomikisht, diaspora vazhdon ta përkrahë Kosovën duke dërguar remitenca të konsiderueshme.

Marrëdhënia midis Kosovës dhe diasporës së saj, në pjesën më të madhe, përbëhet nga valët e ndryshme të migrimit që kanë ndodhur përgjatë gjysmë shekulli. Vala e parë e diasporës ishte ajo që u larguan nga Kosova (1950-1960) ishin kryesisht punëtorë të pakualifikuar. Ata migruan në Gjermani për ta përmbushur mungesën e krahut të punës atje, gjatë bumit ekonomik që pati Evropa pas Luftës së Dytë Botërore. Mërgimtarët tanë vinin kryesisht nga zonat rurale të Kosovës dhe e lanë vendin në kërkim të mundësive më të mira ekonomike jashtë vendit. Vala e dytë e migrimit jashtë Kosovës ishte (1980-1999) për shkak të represionit të drejtpërdrejtë prej shtetit serb. Shumica e mërgimtarëve shqiptarë<sup>1</sup> të Kosovës u larguan nga Kosova për t'i ikur politikave diskriminuese dhe shtypëse të Serbisë, përfshirë këtu luftën e viteve 1998-1999. Vala e tretë dhe aktuale e diasporës (pas 2002) nxitet nga paqëndrueshmëria e vazhdueshme ekonomike dhe politike në Kosovë. Shumë profesionistë të rinj, kryesisht nga zonat urbane, po ikin në kërkim të mundësive për jetë më të mirë në Evropën Perëndimore, me fokus në Gjermani.

Sfidat e integritit të diasporës kosovare në Evropë kanë ndryshuar midis tri valëve të diasporës. Diaspora nga dy valët e para u përballën me sfidat më të mëdha qoftë të asimilimit apo integritit të tyre në shoqëritë e vendeve pritëse. Sikur komunitetet e tjera të diasporës që migruan në Evropë nga vitet 1960 deri 1990, edhe shqiptarët e Kosovës kishin synim që të ktheheshin në vendin e tyre të origjinës. Dy gjeneratat e para të diasporës kishin probleme financiare meqë ofronin mbështetje monetare për familjet në Kosovë. Për më shumë, ata përballëshin me pengesat gjuhësore dhe kulturore të vendit pritës, ndërsa vendosën ta kufizonin ndërveprimin me vendin mikpritës, kryesisht duke mbetur të izoluar dhe duke ndërvepruar vetëm me komunitetin e diasporës shqiptarë atje. Për shumicën e kësaj gjeneratë të diasporës, jeta në Evropën Perëndimore ishte e përkohshme. Sidoqoftë, statusi i tyre i përkohshëm mori gjendje më të përhershme kur më shumë anëtarë të familjes së tyre kërkuan të migrojnë në përfundim, dhe pjesëmarrja e tyre në proceset politike të Kosovës filloi të zbehet.

Natyra e migracionit kosovar dhe qëndrimi i pasardhësve të tyre (të lindur jashtë Kosovës) ndaj atdheut të tyre filluan të ndryshonin, pas ndërhyrjes së NATO-s që solli fundin e okupimit serb, dhe projekti perëndimor i shtet ndërtimit çoi në pavarësinë e Kosovës më 2008. Në krahasim me gjeneratën e parë dhe të dytë të diasporës kosovare (gjeneratat e para me lidhje të fortë me identitetin, kulturën dhe historinë kombëtare të Kosovës), gjenerata e tretë ose ata që u lindën ose rriten në diasporë janë më pak të lidhur me Kosovën.

Entuziazmi fillestar për t'u kthyer dhe për të investuar në vendlindje u frenua në pjesë të madhe për shkak të sfidave me sundimin e ligjit, sigurinë dhe rreziqet e tjera që dëmtojnë klimën e investimeve në Kosovë, për shkak të kapjes së shtetit dhe korrupsionit në institucionet publike në Kosovë.<sup>2</sup> Rrjedhimisht që nga pavarësia, diaspora ka investuar kryesisht në pasuri të paluajtshme në Kosovë, kryesisht i ka ndenjur larg ndonjë investimi të madh në vendlindje. Është me rëndësi të theksohet se nuk ka të dhëna që tregojnë nivelin e investimeve të diasporës në Kosovë. Investimet e diasporës trajtohen si investime direkte të huaja. Sidoqoftë, diaspora kontribuon shumë me remitenca që ia dërgon Kosovës, dhe sipas një raporti të Bankës Qendrore të vitit 2018, remitenca arrijnë në më shumë se 750 milion Euro (Banka Qendrore e Kosovës 2018).

Ndryshimi ndërmjet gjeneratave të diasporës kosovare, si dhe ndryshimet në dinamikën sociale në Kosovë dhe në vendet pritëse, kanë pasur pasoja të dukshme për marrëdhëniet midis Kosovës dhe komuniteteve të saj

1 Në këtë punim, termi "Shqiptarët e Kosovës" u referohet qytetarëve kosovarë të etnisë shqiptare. Ne përdorim termin "shqiptar" edhe për t'iu referuar të gjithë shqiptarëve dhe pasardhësve të tyre që jetojnë në Shqipëri, Maqedoni Veriore, Serbi, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe vende të tjera (përveç Kosovës). Në këtë punim e përdorim edhe termin diasporë kosovare që u referohet shqiptarëve të Kosovës dhe pasardhësve të tyre që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit.

2 Intervistë me një zyrtar të lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Qeveria e Kosovës. Prishtinë, nëntor 2019.

në diasporë. Gjetjet fillestare tregojnë se identiteti kombëtar apo ndjenjat ndaj Kosovës ka rënë paksa në mesin e anëtarëve të brezit të ri të diasporës së Kosovës, sidomos ata që janë lindur ose rritur në Gjermani pas viteve 1990. Për më shumë, të dhënat nga Barometri i Sigurisë së Kosovës 2019 tregojnë se ka dallime në marrëdhëniet me vendin amë ndërmjet brezave të diasporës kosovare (Marku 2019). Kjo më tej ka çuar në një vakum identiteti, meqë diaspora ka kaluar nga një identitet tradicional që lidhet me vendin e origjinës (Kosovës) drejt një të riu që lidhet me vendin mikpritës.

Ashtu sikurse me diasporat e tjera jo-evropiane në gjithë Evropën Perëndimore, disa qytetarë gjermanë me origjinë nga Kosova një formë apo ndjenjë të identitetit të tyre e kanë gjetur në sferën e fesë, pasi kërkojnë të lidhen me një identitet apo përkatësi më të madhe brenda grupi religjioz.<sup>3</sup> Disa prej anëtarëve të diasporës duket se shënjestrohen qëllimisht nga organizatat islamike që kanë shtrirje në komunitete të ndryshme në Gjermani, që kërkojnë të shfrytëzojnë krizën e identitetit me të cilën përballen fëmijët prindërve të cilët migruan ndërmjet viteve 1960 dhe 1990.<sup>4</sup>

Ky punim vëmendje të veçantë i kushton potencialit për radikalizmin të të rinjve nga komunitetet e diasporës dhe mbështetjes që ata u japin grupeve të cilat janë të lidhura me ekstremizmin e dhunshëm. Për nevojat e këtij hulumtimi dhe në përputhje me Planin e Veprimit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, ky fenomen definohet si "si veprim apo sjellje që kërcënon rendin demokratik apo sundimin e ligjit dhe promovon përdorimin e dhunës për të arritur objektivat e tyre si dhe detyron ndjekësit e tyre për të ndërmarrë një gjë të tillë. Kjo formë e ekstremizmit përshkruhet si 'ekstremizëm i dhunshëm', term ky i diskutueshëm që i referohet përgjithësisht përdorimit të dhunës të motivuar ideologjikisht ose politikisht, si dhe mbështetjes për akte të tilla". Prandaj, përkufizimi i ekstremizmit të dhunshëm i miratuar në këtë raport është "përdorimi dhe mbështetja e dhunës për e qëllimeve ideologjike, fetare ose politike" (UNGA 2015).

Ndonëse feja vetë nuk është shtytëse për ekstremizmin e dhunshëm, studiuesit e diasporës pohojnë se përvetësimi i identitetit fetar islam në Evropën Perëndimore shpesh është bërë prej organizatave islamike dhe rrjetit të xhamive të paligjshme që veprojnë në gjithë Evropën (Hoffman et al. 2006). Këto grupe kanë vepruar si rekrutues dhe kanë shërbyer si mundësi për rekrutim për organizatat ekstremiste të dhunshme në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Sipas të dhënave nga agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë dhe të dhënave të autorit, që nga viti 2012, rreth 47 të rinj nga diaspora kosovare në u janë bashkuar organizatave të ekstremizmit të dhunshëm për të luftuar në Siri dhe Irak.

Që nga sulmet e 11 Shtatorit në Shtetet e Bashkuara, ka pasur disa incidente terroriste ku janë përfshirë shqiptarët e radikalizuar të Kosovës që jetojnë në diasporë. Sidoqoftë, diaspora kosovare i ka refuzuar tej mase bashkimin në konfliktet e karakterit fetar me shtrirje globale (p.sh Afganistan, Bosnje). Ndonëse dimë pak për shkaqet dhe faktorët që i kanë bërë këta të rinj të bashkohen nëpër organizata të tilla si Shteti Islamik (IS), numri i atyre që janë bashkuar konflikteve të huaja është shumë i vogël në krahasim me numrin e madh të diasporës kosovare në Gjermani, Evropën Perëndimore dhe ShBA. Megjithatë, nga një këndvështrim i politikave dhe me qëllim të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, kërkohen më shumë hulumtime për të kuptuar shkaqet që bënë që 47 evropianë me origjinë nga Kosova tu bashkohen organizatave si Shtetin Islamik si luftëtarë të huaj (LH).<sup>5</sup>

Qëllimi i këtij hulumtimi është të ofrojë të dhëna bazë për hulumtime të mëtejshme mbi shkaqet e radikalizmit që i shtynë individë nga diaspora kosovare në Gjermani të bashkohen në IS dhe Hayat Tahrir al-Sham dhe të luftojnë në Siri e Irak. Përfshirja e shqiptarëve në organizatat e ekstremizmit të dhunshëm që mbështesin çështjen fetare përbën herën e parë në historinë e diasporës shqiptare të Kosovës që pjesëtarët e saj të përfshihen në një kauzë tjetër përveç luftës së tyre për çlirim kombëtar.

Ky punim synon të ofrojë një fushë të re analizash mbi diasporën kosovare, jo vetëm që ta trajtojë atë "problem", por edhe si mundësi dhe burim që diaspora mund të shërbejë si urë bashkëpunimi midis Kosovës dhe Gjermanisë. Meqë gati gjysma e familjeve të Kosovës kanë së paku nga një anëtar të familjes në Gjermani ose

3 Intervistë me përfaqësuesin e lartë të Shoqatës Islame të Kosovës aktive në Gjermani. Nëntor 2019

4 po aty

5 Ndër këta, 14 luftëtarë ishin nga Gjermania dhe 33 nga shtetet e tjera anëtare të BE-së.

Zvicër (Elezaj et al. 2012), bëhet e domosdoshme të riformulohet debati mbi pjesëmarrjen dhe kontributin e diasporës në dhe për vendin e tyre, si dhe aftësinë e Kosovës për të gjetur mënyra për ta përfshirë diasporën në mënyrë sa më mirë për të ndikuar pozitivisht në zhvillimet në vendet mikpritëse.

Pjesa e parë dhe e dytë e punimit përfshin një analizë të historikut të diasporës kosovare në Gjermani, sfidat me integrimin në shoqërinë gjermane dhe marrëdhëniet me Kosovën si vend i origjinës. Seksioni i tretë ofron një analizë të shkurtër krahasuese të diasporave nga rajoni Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut dhe Kosova, si dhe sfidave me integrimin e tyre në shoqërinë gjermane me të cilat përballen të dyja diasporat. Seksioni i fundit i punimit ofron rekomandime konkrete për politikën, si për autoritetet politike gjermane dhe kosovare, për adresimin e shqetësimeve të diasporës kosovare në Gjermani, në fusha si integrimi i diasporës kosovare në shoqërinë gjermane, si dhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në mesin e diasporës kosovare.

Metodologjikisht, ky raport mbështetet në metodat sasiore dhe cilësore të hulumtimit. Përfundimet e raportit nxirren kryesisht nga përvoja hulumtuese në terren e bërë për më shumë se 6 vite nga autori dhe QKSS, përfshirë vëzhgimin pjesëmarrës dhe shqyrtimin gjithëpërfshirës të raporteve mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm të hartuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Të dhënat e ofruara nga autoritetet e zbatimit të ligjit dhe zyrtarët e sigurisë në Kosovë dhe Gjermani mbi individët e përfshirë në konfliktet në Siri dhe Irak, u përdorën për kryerjen e këtij studimi. QKSS ka krijuar një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse të luftëtarëve të huaj - duke përfshirë moshën, nivelin e arsimit, vendbanimin - nga Kosova dhe diaspora që kanë udhëtuar për t'iu bashkuar Shtetit Islamik. Kjo bazë e të dhënave ofron mjet efektiv për të konfirmuar dhe krahasuar gjetjet nga tri burime të ndryshme. Raporti bazohet edhe në të dhënat e sondazhit nga Barometri i Sigurisë së Kosovës 2019 (BKS), i cili eksploron marrëdhëniet midis diasporës kosovare dhe vendit të tyre të origjinës (Marku 2019).

Si i tillë, ky raport paraqet punën fillestare që mbështetet në analizën e të dhënave, përfshin gjetjet përkatëse nga raportet e tjera të hartuara nga organizata vendore dhe ndërkombëtare që kanë shqyrtuar rolin e komunitetit të diasporës në ekstremizmin e dhunshëm dhe fenomenin e LH nga diaspora, dhe përfundon duke ofruar një vlerësim të rreziqeve dhe kërcënimeve për ekstremizmin e dhunshëm në mesin e komunitetit të diasporës në Gjermani.

## 2. Marrëdhënia e diasporës kosovare në Gjermani me Kosovën

Midis 850 mijë deri në 1 milion shqiptarë të Kosovës jetojnë në Evropën Perëndimore. Shumica, mbi 60 përqind, jetojnë në Gjermani dhe Zvicër. Midis 350 mijë dhe 400 mijë njerëz me origjinë kosovare banojnë vetëm në Gjermani. Gjysma e diasporës që kërkuan strehim në Gjermani, e bënë këtë për t'iu shpëtuar vështirësive ekonomike dhe shtypjes politike të shkaktuar nga okupimi prej Serbisë në vitet 1990. Gjysma tjetër e diasporës kosovare në Gjermani janë fëmijët të diasporës kosovare të lindur dhe rritur në Gjermani (Banka Botërore 2018).

Diaspora kosovare në Gjermani, sidomos nga dy valët e para të migrimit, mbetet e lidhur në mënyrë aktive me atdheun, dhe ka qenë forca lëvizëse prapa të gjitha ndryshimeve që ndodhën në Kosovë në katër dekadat e fundit. Përfshirja e tyre financiare mbetet një nga faktorët kryesorë që e mbajnë gjallë ekonominë e Kosovës. Në të kaluarën, diaspora kosovare në Gjermani ishte përfshirë aktivisht në mbështetjen e përpjekjeve të Kosovës për çlirimin dhe pavarësinë nga Serbia.

Pas konfliktit në Kosovë dhe shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, marrëdhëniet e diasporës kosovare me Kosovën ftohen për një sërë arsyesh si: kapja e shtetit nga elitat e korruptuara, stagnimi ekonomik i Kosovës dhe mungesa e sundimit të ligjit janë disa prej tyre. Gjeneratat e para të mërgimtarëve që ndëruan kujtesën kolektive të luftës çlirimtare dhe aktivizimin, e që u ndien pjesë të suksesit të saj për pavarësim, vazhduan të mbajnë lidhjen e tyre të fortë dhe identitetin e tyre me Kosovën. Nga ana tjetër, brezi i tanishëm i diasporës, i cili nuk kaloi nëpër një proces të tillë, kanë lidhje më të dobët ose nuk kanë lidhje me Kosovën.


Për shkak të natyrës së migrimit të tyre dhe trajektorës së integrimit në Gjermani, brezat e vjetër të diasporës vazhdojnë ta planifikojnë kthimin eventual të përhershëm në Kosovë, ndërsa fëmijët e tyre, të lindur dhe/ose të rritur në Gjermani, e shohin jetën e vet në Gjermani (Sejdiu 2017). Ëndrra e kthimit në vendlindje ishte arsytim për gjeneratën e vjetër të mërgimtarëve kosovarë që t'i rezistonte integrimit dhe asimilimit në shoqërinë gjermane.

Kjo është në përputhje me observimet e studiuesve të migrimit dhe komuniteteve të diasporës si Russell King, i cili arriti në përfundimin se "ëndrra për kthim në vendin e origjinës shërben për të justifikuar mos gatishmërinë ose pamundësinë e mërgimtarëve për t'u përshtatur me kulturën e vendit në të cilin jeton, dhe duke e etiketuar integrimin si asimilim përmes vlerave të huaja" (King 1979: 278).

Besnikëria dhe insistimi i tyre për t'iu përmbajtur traditave të jetës dhe kulturës në Kosovë, si dhe përfshirja e tyre në proceset politike të Kosovës, janë disa nga elementët kryesorë që e kanë mbajtur diasporën kosovare të lidhur fort me Kosovën dhe identitetin e saj kombëtar.


Ky argument vërtetohet më tej nga të dhënat e BSK 2019, anketë e kryer me 1200 amvisni në Kosovë në Tetor 2019 (Mark 2019). Sipas studimit, më shumë se 71% e të anketuarve të intervistuar thanë se kanë të paktën një anëtar të ngushtë të familjes jashtë vendit, kryesisht në Gjermani ose Zvicër.

Figura 1: A keni ndonjë anëtar të familjes që jeton në diasporë? (Burimi: Marku 2019)



Të anketuarit u pyetën edhe nëse diaspora ishte më e lidhur me Kosovën në të kaluarën sesa gjenerata e të rinjve të diasporës kosovare që jeton në Gjermani dhe vendet e tjera të BE-së. Figura 2 më poshtë tregon se 49 për qind e të anketuarve theksuan se situata mbetet e njëjtë dhe asgjë nuk ka ndryshuar, ndërsa 27 për qind e të anketuarve deklaruan se në të kaluarën, diaspora ishte më e angazhuar në çështjet e brendshme të Kosovës. Një numër më i ulët i të anketuarve (18 për qind) pohuan se aktualisht diaspora është më e lidhur dhe më e angazhuar me Kosovën sesa në të kaluarën, ndërsa 6 për qind e të anketuarve nuk kishin një mendim për këtë çështje. Prandaj, sipas këtij studimi, diaspora që rezultoi nga vala e parë dhe e dytë e migrimit duket se mbetet më e lidhur me Kosovën sesa vala e tretë e atyre që migruan të cilët kanë ndjejnë dhe lidhje më të vogël me Kosovën (Marku 2019).

Figura 2: A janë të afërmit tuaj që jetojnë në diasporë më të lidhur me Kosovën tani, apo kanë qenë në të kaluarën? (Burimi: Marku 2019)




### 3. Diaspora kosovare dhe ekstremizmi i dhunshëm në Gjermani

Që nga viti 2011, rreth 6,000 luftëtarë të huaj nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për t'u bashkuar me grupet militante. Në mesin e këtyre luftëtarëve, midis 850 dhe 1000 janë individë që vijnë nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Shtuni 2019). Ndërkohë, një numër i konsiderueshëm i LH-ve nga Gjermania dhe Zvicra me prejardhje nga Ballkani Perëndimor, i janë bashkuar IS. Nuk ka të dhëna të besueshme dhe zyrtare nga vendet e tjera si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia apo Mali i Zi për numrin e qytetarëve të tyre nga diasporë që janë bashkuar me konfliktet në Siri dhe Irak si pjesë e IS ose e grupeve të tjera të dhunshme. Kosova është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor i cili ka publikuar të dhëna për individët e vet nga diaspora që iu kanë bashkuar konflikteve në Lindjen e Mesme. Sipas këtyre të dhënave (Perteshi 2019), nga rreth 250 qytetarë të Kosovës që u bashkuan me IS, 47 kanë lindur ose janë shtetas të vendeve të ndryshme të BE-së, rajonit apo vendeve tjera. Grafiku më poshtë tregon numrin e LH-ve me prejardhje nga secili vend. Gjermania ka numrin më të madh të LH-ve me prejardhje nga Kosova, gjithsej 14, pasuar nga Serbia me 8 dhe Zvicra me 6 (Perteshi 2019).



Figura 3: numri i luftëtarëve të huaj me prejardhje nga Kosova prej secilit vend (Burimi: Perteshi 2017)



Kur krahasojmë numrin e LH-ve me prejardhje nga Kosova me numrin e popullsisë e përgjithshme të diasporës kosovare, shfaqet një pamje tjetër mbi nivelin faktik të radikalizmit në mesin e kësaj popullate në Gjermani dhe Zvicër. Për të krahasuar numrin e LH-ve për kokë banori të diasporës Kosovare, analizuam të dhënat zyrtare të hartuara nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (2019). Nga viti 2014 deri në 2018, rreth 342,000 individë janë regjistruar si anëtarë të diasporës. Edhe pse këto të dhëna nuk tregojnë numrin e saktë të diasporës kosovare, për shkak të mungesës së të dhënave tjera kredibile, ky raport u mbështetet në këto të dhëna si burimi më i besueshëm për t'u përdorur për të bërë analiza krahasuese të LH-ve për kokë banori të diasporës kosovare.

Siç është elaboruar më poshtë, një analizë e e popullatës kosovare të diasporës dhe numrit të LH-ve që iu bashkuan organizatave ekstremiste tregon se numri i LH-ve nga radhët e diasporës kosovare është shumë i vogël dhe i papërfillshëm krahasuar me numrin e përgjithshëm të qytetarëve me prejardhje nga Kosova që jetojnë jashtë vendit. Për më shumë, të dhënat tregojnë se niveli i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në mesin e diasporës kosovare është shumë i vogël dhe nuk është shqetësues.

Vendet me numrin më të madh të LH-ve në proporcion me numrin e popullsisë së diasporës kosovare janë Bosnja dhe Hercegovina, pasuar nga ShBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Suedia. Gjermania, Italia dhe Zvicra kanë numrin më të ulët të LH-ve për kokë banori të popullsisë së diasporës kosovare që jetojnë në këto vende. Megjithatë, lista nuk përfshin LH nga Serbia me origjinë shqiptare sepse ato janë nga komunat me shumicë shqiptare Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, dhe nuk konsiderohen si diasporë.

Figura 4: Numri i Luftëtarëve të huaj nga diaspora kosovare për krye banori

Vendi	Numri i qytetarëve të diasporës	numri i LH me prejardhje nga diaspora e Kosovës	Përqindja e LH në mesin e diasporës totale
Bosnja dhe Hercegovina	310	2	0,5714
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	6753	3	0.0444
Britania e Madhe dhe Irlanda Veriore	8364	3	0.0358

Suedia	15.837	3	0.0189
Norvegjia	5347	1	0.0187
Belgjika	8,500	1	0,0117
Gjermania	126.050	14	0.0111
Italia	16.934	1	0,0059
Zvicra	102.052	6	0,0058

Faktorë të ndryshëm kanë ndikuar që individët e rinj nga diaspora kosovare të anëtarësohen në organizata militante në Siri dhe Irak. Prania e predikuesve fetarë që shpallin lirshëm radikalizmin dhe ideologjinë ekstremiste me bazë fetare në mesin e diasporës nga Ballkani dhe rajoni LMAV në Zvicër e Gjermani është njëri nga faktorët kryesorë që i ndikoi individët e diasporës të anëtarësohen në IS. Nevoja për të jetuar nën "Kalifatin dhe rregullat islame", ndjenja e përkatësisë dhe obligimi fetar dhe detyra për t'i mbështetur myslimanet në Siri, si dhe kriza e identitetit në mesin e disa të rinjve në diasporë, ishin disa nga shkaktarët e rëndësishme që çuan në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm në mesin e diasporës kosovare në Gjermani dhe në vende të tjera.

Shumë studiues të ekstremizmit të dhunshëm, përfshirë studiuesin francez Olivier Roy, kanë arritur në përfundimin se nuk ka një profil të vetëm të një militanti a individi të radikalizuar të prekur nga një ideologji e dhunshme ekstremiste (Roy 2017). Kjo konfirmon gjetjet e hulumtimit të QKSS-së mbi ekstremizmin e dhunshëm. QKSS ka analizuar profilet dhe prejardhjet e gjashtë individëve të caktuar, të angazhuar në IS, që janë rritur në Gjermani. Bazuar në të dhënat e marra nga agjencitë e Kosovës për zbatimin e ligjit dhe zyrtarët e sigurisë, si dhe analizat nga burimet e hapura dhe hulumtimet e mëparshme të QKSS-së, jemi përpjekur të ndërtojmë një profil të një perëndimori me trashëgimi kosovare që i është bashkuar organizatave të dhunshme ekstremiste. Në rastin e Gjermanisë, individët më të radikalizuar të diasporës kosovare janë pjesë e brezit të ri të diasporës, të cilët ose janë larguar nga Kosova në moshë të re për t'i shpëtuar konflikteve të viteve 1990, ose kanë lindur në Gjermani. Ata ndjehen të lënë pas dore shoqërisht, kulturalisht dhe politikisht në Gjermani dhe në vendin e prejardhjes, dhe janë praktikues të rinjtë të religjionit. Megjithatë, feja është sfera ku kanë gjetur ndjenjën e përkatësisë dhe një ndjenjë identiteti (Kursani 2015; 2017).

Një shembull tipik i një ekstremisti të dhunshëm me prejardhje nga Kosova, por që nuk është i lindur a rritur në Kosovë, është Ahrid Uka (mashkull). I lindur në Gjermani më 1990 në një familje kosovare që emigroi atje rreth 45 vjet më parë, Ahrid Uka kreu një sulm në Aeroportin e Frankfurtit dhe vrau dy ushtarë amerikanë në mars 2011. Ky është shembull tipik, edhe pse jo edhe i vetmi i individëve (pak) të lidhur me Kosovën të përfshirë në komplete jashtë vendit (Kursani 2017). Ai as nuk u radikalizua në Kosovë, as nga askush prej Kosove. Uka tha gjatë gjyqimit të tij se ishte radikalizuar nga videot propagandistike xhihadiste që kishte parë në internet (BBC 2012). Ai u radikalizua dhe u ndikua nga videot e përleshjeve midis forcave amerikane dhe organizatave të armatosura në Afganistan. Sipas tij, sulmin kundër ushtarëve amerikanë e kreu si një akt hakmarrjeje për përfshirjen e ShBA-së në Afganistan.

Një rast tjetër përfshin një shtetas gjerman me prejardhje nga Kosova që udhëtoi për në Siri për të luftuar për IS. Kreshnik Berisha (mashkull) lindi në Frankfurt, Gjermani, më 1994 në një familje shqiptare të Kosovës që kishte emigruar gjatë viteve 1980 për të shpëtuar nga represioni i Serbisë në Kosovë (CNN 2014). Berisha, i cili nuk kishte asnjë lidhje me Kosovën, ishte anëtar i parë i dyshuar i IS-it që u gjykua në Gjermani. Ai u arrestua pas mbërritjes në Frankfurt në dhjetor 2014, pasi kish kaluar gjashtë muaj në Siri si anëtar i IS (BBC 2014). Berisha është rritur në Frankfurt dhe si i ri luante futboll për Makkabi Frankfurt, një klub hebre (Knight 2014). Studioi inxhinieri ndërtimi në një kolegji profesional në Frankfurt dhe u shoqërua me njerëz me prejardhje nga Lindja e Mesme. Ndërsa ishte në kolegji i ishte ekspozuar interpretimit radikal fetar të Islamit, dhe përfundimisht u bashkua me një grup militant islamik. Berisha ishte pjesë e një rrjeti të individëve që e perceptojnë veten si mbrojtës të popullsisë myslimanë në gjithë botën, dhe mbrojtës të Islamit, për të cilin mendojnë se është nën sulm nga perëndimi. Këto besime janë arsyeja për udhëtimin e Kreshnik Berishës në Siri për t'u bashkuar me IS. Gjatë gjyqimit të tij në Gjermani, Berisha pohoi: "Dhuna e tmerrshme e përdorur nga regjimi i Alavit i Asadit kundër shumicës sunite, më tërhoi dhe më egërsoi. Askush nuk donte t'i ndihmonte njerëzit e atjeshëm"( Knight

2014). Ndjenja e solidarizimit dhe nevoja për përkrahje të myslimaneve sunitë në Siri përdoret nga shumica e luftëtarëve të huaj nga Kosova.

F.S. një tjetër luftëtar i huaj nga Kosova, tha në një intervistë me një TV lokal në Kosovë se iu bashkua IS-it për t'i mbështetur vëllezërit myslimane në Siri kundër regjimit të Asadit (Portali RTV 2017). Në shumicën e rasteve, këta individë janë në kërkim të ndjenjës së përkatësisë në një komunitet të ri dhe më të madh të myslimanëve, të pakufizuar nga diversiteti i Islamit, i cili praktikohet me shekuj në vendet e tyre të prejardhjes (Perteshi 2019).


Identiteti fetar i myslimanëve të rinj evropian u hulumtua edhe nga studiuesi francez Olivier Roy. Sipas Roy, Evropa Perëndimore është shtëpia e dy versioneve të praktikimit të Islamit. I pari u importua nga gjeneratat e mëparshme të mërgimtarëve që mbanin lidhje të ngushta identiteti me vendin e prejardhjes dhe që e sollën Islamit si pjesë të traditës së tyre kulturore në Evropë. Versioni i dytë pretendon universalitet dhe ndiqet nga myslimanet e lindur në Evropë, të cilët imagjinojnë dhe projektojnë vetveten si pjesë të një Umeti global (bashkësie), jo të lidhur me vendin e prejardhjes së prindërve të tyre, por si pjesë e një bashkësie transnacionale, të imagjinuar të besimtarëve (Güvenich 2018). Versioni i parë i Islamit, i praktikuar nga gjeneratat e mëparshme të diasporës që e mbajnë vendin e prejardhjes si pikë referimi, ishte i mishëruar ngushtë me identitetin kombëtar, ndërsa i dyti është element global ideologjik i radikalizmit. Ky i fundit është lloji i pan-Islamizmit mbi të cilin ngrihen versionet radikale të Islamit. Ekzistojnë versione jo-ekstremiste të pan-Islamizmit, të cilat pohojnë se mund të kesh edhe identitet kombëtar edhe identitet mysliman. Roy vëren se organizatat e gjeneratës së parë të diasporës e ushtruan aktivitetin e tyre politik në vendin e prejardhjes, dhe më së shumti, synonin ta ndikonin politikën e vendit mikpritës drejt vendit të prejardhjes. Në rastin e identitetit fetar ideologjik që i përket brezit aktual të myslimanëve evropianë, Roy pohon se "duke mbrojtur Umetin global, ata adresojnë dëshirën universale myslimane të cilët nuk duhet të identifikohen si komb apo nga ndonjë vend i caktuar" (Roy 2004: 58). Për më shumë, ky radikalizmin i gjeneratës aktuale të myslimanëve të Evropës "është i lidhur me vakumin identitar ndërmjet gjeneratave si dhe statusin të dobët social të tyre" (po aty: 60).

## 4. Krahasimi me luftëtarët e huaj gjermanë nga diaspora LMAV

Një numër i lartë i LH-ve nga komunitete të ndryshme diasporave që jetojnë në Gjermani i janë bashkuar Shtetit Islamik. Ky seksion shqyrton shkurtimisht dinamikën e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm të komuniteteve të diasporave me prejardhje nga rajoni LMAV, dhe provon të bëjë një krahasim me trendet dhe faktorët e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm midis pjesëtarëve të diasporës shqiptare në Gjermani.

Shifrat zyrtare të publikuara nga Ministria Federale Gjermane e Punëve të Brendshme e vendosin numrin e myslimanëve që jetojnë në Gjermani mes 4,4 dhe 4,7 milion (Ministria Federale e Punëve të Brendshme 2020). Ndër ta, rreth 50% janë me origjinë turke, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë përfshin kurdë, palestinezë, sirianë, popuj nga ish-Jugosllavia dhe Federata Ruse (po aty). Për më shumë, të dhënat zyrtare nga autoritetet gjermane të sigurisë dhe vlerësimet e inteligjencës tregojnë se prej vitit 2012, më shumë se 910 individ nga Gjermania janë larguar për të luftuar në Siri ose Irak (Heinke 2017). Sipas të njëjtit burim, rreth një e treta e atyre që u nisën për t'u bashkuar me Shtetin Islamik ose me fraksione të tjera islamike, dihen ose supozohen se janë kthyer në Gjermani dhe ende ndodhen nën hetime. Prejardhja etnike e atyre LH-ve gjermanë zbulon se shumica janë mërgimtarë të gjeneratës së dytë ose të tretë të lindur në Gjermani, me lidhje të dobëta ose pa ndonjë lidhje me vendet e prejardhjes në Lindjen e Mesme ose Afrikën e Veriut, Kaukazin Jugor ose Ballkanin Perëndimor. Bazuar në të dhënat e autoriteteve gjermane 61 për qind e atyre që iu bashkuan Shtetit Islamik në Siri dhe Irak kanë lindur në Gjermani, dhe të tjerët në një gamë të gjerë të vendeve të tjera të lindjes (38 vende). Kombësitë me numrin më të madh të luftëtarëve të huaj që udhëtonin nga Gjermania përfshijnë Turqinë (6%), Sirinë (5%), Federatën Ruse (5%), Marokun (3%) dhe Libanin (3%). Diku rreth 200 luftëtarë të huaj të rekrutuar në Gjermani janë nga këto vende. Rreth 145 luftëtarë të tjerë të huaj janë nga diaspora palestineze, kurdë, nga Ballkani, vendet e Kaukazit të Jugut, etj. (Heinke 2017).

Figura 5: Luftëtarët e huaj gjermanë sipas prejardhjeve etnike (Burimi: Heinke 2017).



Në përgjithësi, gjeneratat e para të mërgimtarëve myslimane me prejardhje nga vendet Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut -LMAV vazhduan të praktikojnë fenë e tyre pas migrimit në Gjermani. Praktika dhe edukimi i tyre fetar lidheshin fort me prejardhjen e tyre kulturore, ndërlidheshin me traditën, kombëtare dhe etnike, duke i bërë këta individë më rezilient ndaj çdo forme të ideologjisë ekstremiste islamike. Nga ana tjetër, brezi i ri i diasporave nga vendet LMAV, të lindurit ose të rriturit në Gjermani, ose kanë marrëdhënie të zbehtë ose nuk kanë fare me vendlindjet e prindërve të tyre. Rrjedhimisht, mënyra e tyre e praktikimit të religjionit është më radikale të cilët kanë formuar një identitet të ri fetar (Fouroutan 2013). Ky proces i "Islamizimit të madh" në Gjermani nuk kontrollohet dhe as lidhet me elementet kulturore, kombëtare dhe etnike të vendeve të prejardhjes, çka e bën brezin e tashëm të diasporës myslimanë më të cenueshëm dhe më të prirur ndaj ideologjive ekstremiste të dhunshme me bazë fetare (po aty). Ndërsa prindërit vazhdojnë ta ruajnë mënyrën tradicionale të praktikimit të Islamit, një numër i vogël i fëmijëve të tyre, të cilët duan ta shohin veten si praktikuesit e vërtetë të Islamit, të cilët në të shumtën e rasteve janë mirë të edukuar, e praktikojnë Islamin duke u bazuar në literaturë, dhe duke mos lejuar traditën dhe kulturën e vendit të tyre të origjinës të ndikojnë në mënyrën e tyre të praktikës dhe besimit.

Në Gjermani, diasporat nga rajoni LMAV e kanë përdorur Islamin si mjet për ta parandaluar asimilimin kulturor, etnik dhe fetar (Green 2014), dhe shumë janë përpjekur t'i formojnë dhe të jetojnë nëpër komunitete sikur geto, ku i kanë rezistuar me sukses asimilimit të plotë në jetën shoqërore gjermane (Eëing 2003). Për krahasim, pjesëtarët e diasporës kosovare kryesisht janë mbështetur në identitetin kombëtar si një mekanizëm për të mbajtur lidhje të forta me Kosovën. Këto lidhje i kanë ndihmuar që t'i ruajnë elementet tradicionale dhe kulturore në besimin dhe praktikën e tyre fetare, duke i bërë më rezistues ndaj formave të ndryshme të ekstremizmit të bazuar në fe.

## 5. Përfundime dhe rekomandime

Numri i personave nga diaspora kosovare që iu bashkuan organizatave të dhunshme ekstremiste nuk është fare reprezentativ krahasuar me numrin e qytetarëve të Kosovës që jetojnë në diasporë në Gjermani. Kosova ka tri gjenerata të diasporës që udhëtuan në Gjermani gjatë periudhave të ndryshme. Brezi i parë i diasporës kosovare ka një lidhje më të fortë me Kosovën sesa gjenerata e tashme.

Ky punim nuk gjeti ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë mes dinamikës së ekstremizmit të dhunshëm në diasporën e Kosovës dhe fenomenit të radikalizimit në vetë Kosovën. Disa individë nga diaspora kosovare që u nisën si LH

për në Siri dhe Irak ishin në të 20-tat e hershme, ishin lindur ose rritur në Gjermani dhe kishin pasur ndjenja të përjashtimit social dhe politik nga sfera publike gjermane.

Ndërsa diasporat nga vendet LMAV në Gjermani e kanë përdorur fenë si mjet për të ruajtur identitetin, për t'u mbrojtur nga asimilimi dhe për të mbajtur marrëdhënie me vendlindjet, diaspora kosovare është mbështetur kryesisht në identitetin kombëtar dhe politik si burim i lidhjes shoqërore. Përfshirja e diasporës në proceset politike kosovare dhe përpjekjet për shtet ndërtim shërbyen si platformë për ta forcuar lidhjen e fortë të diasporës me Kosovën. Përkushtimi për çështjen kombëtare dhe edukimin fetar i bazuar në traditën fetare e kulturore të Kosovës janë dëshmuar si mekanizëm i fortë për të parandaluar që ideologjia ekstremiste me bazë fetare të mos mishërohet me diasporën e kaluar dhe atë aktuale kosovare.

Bazuar në këto gjetje, dolën këto rekomandime të politikave:

1. Duhet bërë një vlerësim të përgjithshëm rreziqeve dhe kërcënimeve të lidhura me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në mesin e diasporës kosovare në Gjermani.
2. Projektet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm mes diasporës së Kosovës duhet të hartohen në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën e Kosovës në Berlin dhe Shoqatat Kulturore e Politike të Kosovës që veprojnë në Gjermani. Aktivitetet për parandalimi ekstremizmit të dhunshëm në të ardhmen për diasporën e Kosovës në Gjermani duhet të përfshijë elementet kombëtare (gjuhë, histori, vlera) dhe traditat në praktikimin e fesë dhe aspektet kulturore të Kosovës për të siguruar zbatimin e tyre të suksesshëm.
3. Duhet të miratohet dhe zbatohet një program i përbashkët shumëvjeçar, i hartuar nga autoritetet shtetërore gjermane dhe kosovare, që përfshin aktivitete kulturore dhe edukim fetar të diasporës kosovare në Gjermani. Ky program do të kontribuojë në parandalimin e ideologjive të dhunshme ekstremiste në mesin e diasporës kosovare dhe do ta bëjë diasporën më rezistuese ndaj të gjitha llojeve të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm.
4. Qeveria e Kosovës duhet të hartoj politika për të rritur përfaqësimin politik të diasporës në institucionet e Kosovës. Një hap i tillë do të inkurajonte përfshirjen qytetare të diasporës në procesin e shtet ndërtimit në Kosovë, përtej remitancave.
5. Me zbehjen e shpejtë të shpresave të mëparshme për integrim në BE të Ballkanit Perëndimor, diaspora mund t'i ndihmojë në marrëdhëniet bilaterale të Kosovës me vendet e Bashkimit Evropian, duke shërbyer si urë komunikimi midis Kosovës dhe vendeve në Evropën Perëndimore.

## Referenca

**BBC News** 2012. Frankfurt airport gunman jailed for life. BBC Neës, February 10, 2012. Gjetet në: [www.bbc.com/neës/ëorld-europe-16984066](http://www.bbc.com/neës/ëorld-europe-16984066) [accessed June 3, 2020].

**BBC News** 2014. Germany jails Islamic State jihadist Kreshnik Berisha. BBC News, December 5, 2014. Gjetet në: [www.bbc.com/neës/ëorld-europe-30344625](http://www.bbc.com/neës/ëorld-europe-30344625) [accessed June 3, 2020].

**Banka Qendrore e Kosovës** 2018. Financial Stability Report 2018, Pristina. Gjetet në: [https://bqk-kos.org/repository/docs/2018/CBK\\_FSR\\_13.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/2018/CBK_FSR_13.pdf) [accessed June 26, 2020].

**CNN** 2014. From Jeëish football to jihad: German ISIS suspect faces jail. CNN, October 21, 2014.

- Elezaj, Ereblina, Faton Bislimi & Iris Duri** 2012. Kosovo Remittance Study 2012. United Nations Development Programme.
- Ewing, Katherine Pratt** 2003. "Living Islam in the Diaspora: Between Turkey and Germany". *The South Atlantic Quarterly* 102, no. 2 (2003): 405-431.
- Ministria Federale Gjermane e Punëve të Brendshme** 2020. Islam in Germany. Gjendet në: [www.bmi.bund.de/DE/themen/heimat-integration/staat-und-religion/islam-in-deutschland/islam-in-deutschland-node.html](http://www.bmi.bund.de/DE/themen/heimat-integration/staat-und-religion/islam-in-deutschland/islam-in-deutschland-node.html) [accessed June 26, 2020].
- Foroutan, Naika** 2013. Identity and (Muslim) Integration in Germany. Migration Policy Institute, March 2013. Gjendet në: [www.migrationpolicy.org/research/identity-and-muslim-integration-germany](http://www.migrationpolicy.org/research/identity-and-muslim-integration-germany) [accessed June 3, 2020].
- Green, Todd** 2014. Islam, Immigration, and Identity. Basel: MDPI.
- Güvenich, Eren** 2018. Interview with French extremism researcher Olivier Roy. They love death as they love life: Jihad and the roots of terror. *Quantara.de*, July 19, 2018. Gjendet në: <https://en.quantara.de/content/interview-with-french-extremism-researcher-olivier-roy-they-love-death-as-they-love-life-jihad?nopaging=1> [accessed June 3, 2020].
- Heinke, Daniel H.** 2017. The German Foreign Fighters in Syria and Iraq: The Updated Data and its Implications. In: *CTC SENTINEL* 10 (3): 17-22. Gjendet në: [https://ctc.usma.edu/ep-content/uploads/2017/03/CTC-Sentinel\\_Vol10Iss326.pdf](https://ctc.usma.edu/ep-content/uploads/2017/03/CTC-Sentinel_Vol10Iss326.pdf) [accessed June 3, 2020].
- Hoffman, Bruce, Éilliam Rosenau, André J. Curiel, & Doron Zimmermann** 2007. The Radicalisation of Diasporas and Terrorism – A Joint Conference by RAND Corporation and the Center for Security Studies, ETH Zurich. RAND Corporation. Gjendet në: [www.rand.org/pubs/conf\\_proceedings/CF229.html](http://www.rand.org/pubs/conf_proceedings/CF229.html) [accessed June 3, 2020].
- King, Russell** 1979. *The Myth of Return: Pakistanis in Britain*. Edited by Muhammad Anwar. London: Heinemann.
- Knight, Ben** 2014. German ISIS suspect offered shorter jail term in return for information. *The Guardian*, September 15, 2014. Gjendet në: [www.theguardian.com/world/2014/sep/15/german-isis-suspect-shorter-jail-term-information](http://www.theguardian.com/world/2014/sep/15/german-isis-suspect-shorter-jail-term-information) [accessed June 3, 2020].
- Kursani, Shpend** 2015. Report inquiring into the causes and consequences of Kosovo citizens' involvement as foreign fighters in Syria and Iraq. Kosovar Centre for Security Studies (KCSS). Gjendet në: [www.qkss.org/repository/docs/Report\\_inquiring\\_into\\_the\\_causes\\_and\\_consequences\\_of\\_Kosovo\\_citizen\\_s%27\\_involvement\\_as\\_foreign\\_fighters\\_in\\_Syria\\_and\\_Iraq\\_307708.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Report_inquiring_into_the_causes_and_consequences_of_Kosovo_citizen_s%27_involvement_as_foreign_fighters_in_Syria_and_Iraq_307708.pdf) [accessed June 3, 2020].
- Kursani, Shpend** 2017. Kosovo Risk Assessment Report Since Independence: February 2008- June 2017. Kosovar Centre for Security Studies (KCSS). Gjendet në: [www.qkss.org/repository/docs/KS-RiskAssessment-eng\\_201377.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KS-RiskAssessment-eng_201377.pdf) [accessed June 3, 2020].
- Marku, Donika** 2019. Kosovo Security Barometer – Ninth Edition. Kosovar Centre for Security Studies (KCSS). Gjendet në: [www.qkss.org/repository/docs/KSB2019\\_339996.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2019_339996.pdf) [accessed June 3, 2020].
- Perteshi, Skender** 2019. Beyond the Triggers – Neë threat of Violent Extremism in Kosovo. Kosovar Centre for Security Studies (KCSS).
- Portali RTV 21** 2017. Flet ish-luftetari i ISIS-it–10.04.2017. Gjendet në: [www.youtube.com/watch?v=R\\_BRm0YD50c](http://www.youtube.com/watch?v=R_BRm0YD50c) [accessed June 3, 2020].
- Roy, Olivier** 2017. *Jihad and Death: The Global Appeal of Islamic State*. London: Hurst & Co.
- Roy, Olivier** 2004. *Globalised Islam. The Search for a Neë Ummah*. Neë York: Columbia University Press.
- Sejdiu, Mehdi** 2017. ËHY THE KOSOVAR DIASPORA IS MORE CONSERVATIVE AND ËHY THIS IS IMPORTANT. *Kosovotëopointzero*, September 05, 2017. Gjendet në: <https://kosovotëopointzero.com/en/kosovar-diaspora-conservative-important/> [accessed June 3, 2020].
- Shtuni, Adrian** 2019. Eastern Balkans Foreign Fighters and Homegrown Jihadis: Trends and Implications. In: *CTC SENTINEL* 12(7): 18-24.

**United Nations General Assembly (UNGA)** 2015. Plan of Action to Prevent Violent Extremism: Report of the Secretary-General. United Nations General Assembly, December 24, 2015. Gjetet në: [www.un.org/en/ga/search/vieë\\_doc.asp?symbol=A/70/674](http://www.un.org/en/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/70/674) [accessed June 3, 2020].

**World Bank Report** 2011. Migration and Economic Development in Kosovo. May 25, 2011. Gjetet në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/247751468266378475/pdf/605900ESÖP123000Migration0Econ0Dev.pdf> [accessed June 3, 2020]